



AKADEMIA • ACADEMY
TEMPULLI

**PLAN STRATEGJIK
2021-2025**

AKADEMIA TEMPULLI

Prishtinë, Dhjetor 2020

Hyrje

Procesi i hartimit të planit strategjik

Plani Strategjik për zhvillimin e Akademisë Tempulli për vitet 2021-2025 është hartuar nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje të gjerë të personelit, partnerëve strategjik dhe të ekspertizës në dispozicion në Kosovë. Procesin e hartimit e ka udhëhequr Menaxhmenti i lartë i Akademisë Tempulli që për këtë qëllim ka krijuar Grupin punues me përfaqësues nga Këshilli Drejtues, menaxhmenti, personeli (akademik dhe administrativ) dhe përfaqësues nga akterët e jashtëm (bizneset). Akademia Tempulli, po ashtu ka angazhuar ekspertë të akreditimit për rishikim të dokumenteve (për të parë harmonizimin me Manualin e Akreditimit) dhe planifikimit strategjik për moderimin e procesit dhe për mbledhjen e organizimin e materialeve të shkruara nga anëtarët e grupeve.

Grupi punues ka mbajtur tri mbledhje koordinuese me përfaqësues të ekipeve dhe me ekspertët e angazhuar në të cilat janë kryer veprimet në vijim:

- Punëtorja 1: Vlerësimi i gjendjes përmes analizës SWOT
- Punëtorja 2: Përcaktimi i vizionit, misionit dhe objektivave strategjike, treguesit kryesorë të performancës dhe caqet
- Punëtorja 3: Kostimi i aktiviteteve, zhvillimi I kornizës për Vlerësimin dhe parandalimin e rreziqeve, dhe plani i komunikimit dhe plani i monitorimit.

Në fund, plani i finalizuar u është dërguar në shqyrtim të fundit anëtarëve të grupeve punuese, është miratuar nga Këshilli Drejtues dhe është dërguar për përkthim.

Plani Strategjik 2021 – 2025 paraqet vizionin zhvillimor të Akademisë Tempulli në pesë vitet e ardhshme. Plani është plotësisht në përputhje me Kornizën Ligjore dhe me kornizën e akreditimit në fuqi në Kosovë. Në periudhën e ardhshme zhvillimore përfshihen zhvillime fundamentale që do ta përcaktojnë dhe konsolidojnë vendin e Akademisë Tempulli në skenën e arsimit të lartë profesional në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe parashihet kalimi në objektin e ri, forcimi i bashkëpunimit me partnerët dhe institucionet vendore e ndërkombëtare, avancimi i administratës dhe i shërbimeve të digjitalizuara, avancimi i cilësisë dhe i përfshirjes së studentëve në një numër shumë më të madh të shërbimeve arsimore në shkencat e aplikuara, arsimin e lartë profesional, shërbime komunitare, ekspertiza në trafik, kurse të shkurta aftësuese dhe në programe atraktive studimore.

Analiza e gjendjes

Përshkrimi i gjendjes

Akademia Tempulli (në tekstin e mëtuftjeshëm “Akademia”), edhe pse si institucioni i ri, menaxhmenti, kuadri mësimor dhe administrative ka një traditë shumëvjeçare nga viti 1992, dhe atë si qendër aftësimi dhe edukimi i kandidatëve të rinj për ngasës të automjeteve. Si rezultat i përkushtimit dhe nevojave të tregut, kjo qendër ka evluar ndër vite, është rritur dhe zhvilluar edhe me programe profesionale në kuadër të Akademisë.

Kosova ka kaluar dhe vazhdon të kalojë nëpër një tranzicion dhe procese aspak të lehta transformuese në dekadat e fundit. Ky proces i vështirë dhe kërkues ka ndikuar në të gjithë sektorët e jetës, përfshirë dhe arsimin. Baza e këtij ndryshimi është edhe sistemi ekonomik, prej atij të centralizuar në ekonomi të lirë të tregut. Të dy këto komponent ngushtë të lidhura, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë indikator që ne të përgatitjen e studentit për pozicionim në karrierë si dhe në anën tjetër prej këtu të ndërtojmë lidhjen me zhvillimin e ekonomisë së tregut.

Akademia e kupton se ekzistimi i një numri të madh të kolegjeve në Kosovë që janë bartës të arsimit të lartë do të thotë se ato kanë nevojë dhe duhet të promovojnë vepra origjinale dhe unike. Kështu, Akademia do të krijojë mekanizma më efektive për llogaridhënie, duke besuar se kjo, së bashku me sugjerimet dhe kritikën, do të ndihmojë Akademinë për të përmirësuar më tej cilësinë në institucionet e arsimit të lartë, veçanërisht të Akademisë.


Akademia, planifikon rolin kryesor në organizimin, promovimin, mbështetjen e resurseve humane dhe financiare në fushën e trafikut dhe transportit. Duke shkuar përtej saj, duke kontribuar vazhdimisht dhe në mënyrë aktive në vetëdijësimin të qytetarit për rregullat e trafikut dhe rëndësinë e tij për jetë të dinjitetshme dhe si pjesëtarë i shoqërisë. Akademia udhëheq Projektin Nacional “Siguria Rrugore” që është zhvilluar së bashku në bashkëpunim me partnerët e Forumit të Kosovës për Siguri Rrugore dhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Policia e Kosovës dhe Shoqata e Motorizimit të Kosovës AMRKS.

Në kuadër të shërbimeve komunitare, Akademia, për shumë vite me radhë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, organizon dhe realizon ligjëratat në shkolla fillore me tematikë zbatimi i rregullave të lëvizjes në rrugë dhe pasojat e aksidenteve rrugore.

Akademia që nga themelimi i ka kushtuar një rëndësi të madhe bashkëpunimit me bizneset, ku studentët mund të kryejnë praktikë profesionale, prandaj Akademia ka themeluar edhe Qendrën për Kërkim dhe Zhvillim Profesional, e cila përbëhet nga anëtarë të institucioneve dhe bizneseve me të cilat bashkëpunojmë. Përmes kësaj qendre, Akademia do të promovojë më shumë ndërveprim me bizneset dhe industrinë, duke përfshirë zhvillimin e vazhdueshëm profesional, kërkimin bashkëpunues, këshillimin dhe licencimin. Fokusi do të jetë gjithashtu puna e partneritetit dhe zhvillimi i aftësive dhe shërbimeve inovative për të promovuar një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Struktura e Akademisë Tempulli

Struktura organizative e Akademisë është përcaktuar me Statutin e Akademisë, në harmoni të plotë, me kompetencat e përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovë.



Rezultatet e analizës SWOT

Përparësitë

- Tradita e Akademisë si qasje të re e studimit për të rinjtë, me atë të ndërthurjes së programeve profesionale, me ato të potenciale akademike dhe ato të mësimit profesional;
- Stafi akademik dhe profesional me kualifikime adekuate;
- Laboratorë bashkëkohorë për pjesën praktike dhe pajisje të nevojshme audio-vizuale për realizimin e procesit mësimor ;
- Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare për siguri rrugore, mobilitet, transport, sigurime;
- Marrëveshje të konsiderueshme bashkëpunimi ndërinstytucionale me organizata të ndryshme në fushën e trafikut, transportit, sigurimeve dhe energjisë;
- Kapacitete të përgatitura profesionale për realizimin e ekspertizave në fushën trafikut, transportit, sigurimeve dhe energjisë;
- Organizimi i hulumtimeve në bashkëpunim me institucione të vendore dhe ndërkombëtare (arsimore, të sigurisë, të emergjencave);
- Ofrimi i kualifikimeve dhe shkathtësive relevante për tregun e punës në fushën e trafikut dhe transportit dhe sigurisë rrugore;
- Përfitimi i komunitetit si rezultat i vetëdijesimit të qytetarëve me anë të kampanjave për rëndësinë e respektimit të rregullave të trafikut në rrugë;
- Fushat dhe profilet specifike të studimit, unike për Arsimin e Lartë në Kosovë;
- Aktivitete të rregullta për rritjen e sigurisë rrugore në nivel nacional dhe rajonal.

Dobësitë dhe sfidat

- Mungesa e sistemit për mbledhjen e informacioneve për trendët në tregun e punës;
- Infrastruktura dhe parking jo i mjaftueshëm;
- Mungesa e sistemit për mbledhjen e informacionit për trendet e tregut të punës
- Nevoja e draftimi i rregulloreve të brendshme në frymën e legjislacionit në fuqi, statutit të Akademisë dhe të standardeve të sigurimit të cilësisë të arsimit të lartë në Kosovë;
- Njohja e gjuhëve të huaja nga e gjithë stafi akademik dhe administrative i Akademisë.

Mundësitë

- Çasja në Projektet dhe fondet ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë;
- Bashkëpunimi shkencor dhe profesional me Institucione relevante kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Pjesëmarrja në realizimin e projekteve konkrete në praktikë të cilat financohen nga Institucione vendore dhe ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi në nivel vendor dhe nacional për realizimin e punës praktike të studentëve;
- Përmbylljen e nevojave të tregut për aftësim profesional dhe shkencor, përfshirë këtu edhe trajnimet profesionale për profesione të caktuara nga fusha e trafikut, transportit, sigurimeve dhe energjisë.

- Zgjerimi i profileve të reja të studimit.

Rreziqet

- Ndryshimet e shpeshta në Udhëzimet Administrative të Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe nevoja për harmonizim dhe kompletim të kornizës ligjore në arsimin e lartë;
- AKA – ndërrimet e shpeshta të kriterëve e standardeve dhe mungesa e ekspertizës në fushat specifike;
- Mos akreditimi institucional i Akademisë;
- Mundësitë e kufizuara për mobilitete (vizat, gjuha, mundësitë financiare);
- Emigrimi i popullatës, me fokus në gjeneratat e reja dhe ikja e kuadrove profesionale nga Kosova;
- Paragjykimet ndaj arsimit privat në Kosovë;
- Qasje jo konstruktive e autoriteteve arsimore ndaj disa IAL private;
- Konkurrenca joparimore në mes të institucioneve private të AL.

Vizioni i Akademisë

Institucion unik i arsimit të lartë në vend dhe rajon, me fokus në zhvillimin e shkathtësive kërkimore profesionale përmes ndërlikohjes së mësimdhënies inovative, mësimi praktik dhe punës shkencore për të mirën e komunitetit

Misioni

Përgatitja në mënyrë cilësore studentët dhe kursantët me njohuritë dhe aftësitë adekuate për të mësuar dhe hulumtuar në mënyrë që të udhëheqin një karrierë të suksesshme profesionale dhe, së bashku me akademinë si dhe individualisht, të kontribuojnë me përgjegjësi për komunitetin.

Akademia Tempulli kontribuon në shoqëri përmes:

- Programet unike të studimit në arsimin e lartë dhe shkencat e aplikuara ose, tregun e punës në Kosovë;
- Avancimi, krijimi dhe shpërndarja e njohurive përmes kërkimit shkencor me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së popullatës;
- Sigurimi i një mjedisi që rezulton me lëvizjen sociale dhe zhvillimin personal;
- Shërben si një partner lokal për bizneset dhe industrinë, institucionet lokale dhe qendrore dhe komunitetin;
- Zbaton dimensionin shoqëror të Bolonjës dhe qasjen e bazuar në të Drejtat e Njeriut;

Për më tepër, Akademia Tempulli angazhohet vazhdimisht në një dialog dinamik me partnerët ekonomikë dhe socialë për të ofruar shërbime përkatëse arsimore dhe kërkimore, të cilat rezultojnë në një raport të lartë të punësimit midis të diplomuarve të saj.

Akademia Tempulli siguron që vizioni dhe misioni të njihet nga i gjithë komuniteti akademik brenda Akademisë përmes përfshirjes së tyre në çdo proces të rishikimit / hartimit dhe miratimit të politikave, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera përkatëse. Qëllimi i përfshirjes së tyre në këto procese nuk është vetëm njohja zyrtare e këtyre dokumenteve, por edhe ndërgjegjësimi i secilit anëtar të komunitetit akademik për rolet, detyrat dhe përgjegjësitë që secili prej tyre mbart për përmbushjen e përgjithshme të misionit. Për më tepër, kur miraton Planin Strategjik, Akademia Tempulli gjithashtu ka zhvilluar një strategji komunikimi, e cila parashikon përpilimin e materialeve të informacionit për palët e interesit, duke përfshirë partnerët, komunitetin dhe bizneset.

Për të përmbushur misionin e saj, Akademia Tempulli ka përcaktuar disa objektiva strategjike për pesë vitet në vijim.

Grupi i punës i planifikimit ka përcaktuar që për secilën fushë të ndërhyrjes duhet të ketë një objektiv strategjik si më poshtë:

1. Vendosni një menaxhim dhe administrim efektiv për të mbështetur proceset akademike dhe kërkimore.
2. Sigurimi i mbështetjes së shtuar për procedurat transparente dhe pjesëmarrëse të sigurimit të cilësisë.

3. Përparoni kushtet e punës dhe krijoni një kulturë të përsosmërisë, inovacionit dhe përdorimit të teknologjive të reja me qëllim të zhvillimit të cilësisë së shërbimeve arsimore dhe kërkimore.

Treguesit e performancës janë parashikuar për secilën nga masat, për të cilat gjenerohen të dhëna rregullisht në mënyrë që të matet progresi i zbatimit të Planit Strategjik. Masat janë pjesë e planit vjetor dhe semestral të punës për secilin anëtar menaxherial, akademik dhe administrativ brenda Akademisë Tempulli, me qëllim për të siguruar që çdo hap i ndërmarrë, të kontribuojë në përmbushjen e misionit dhe vizionit të Akademisë Tempulli.

Vlerat dhe parimet

Vlerat dhe parimet që janë pjesë e rrugës sonë gjatë përballimit të sfidave aktuale:

- **Vlerat:** Akademia ka një qasje ndaj të tjerëve e cila reflektohet në mënyrën se si ata vlerësojnë kontributin e tyre. Akademia tregon respekt në të gjitha marrëdhëniet e saj me palët e interesit, përfshirë marrëdhëniet midis stafit menaxhues dhe mënyrës se si ajo komunikon me partnerët, financuesit dhe ofron shërbime për qytetarët.
- **Integriteti:** Akademia do të fitojë besim dhe respekt duke qenë profesionale, etike, e ndershme dhe e paanshme. Ndershmëria dhe sinjeriteti në të gjitha marrëdhëniet dhe komunikimet e Akademisë siguron që informacioni të jetë në kohë dhe i vërtetë.
- **Përfshirja:** Akademia është e përkushtuar ndaj diversitetit, barazisë së mundësive dhe drejtësisë sociale për të gjithë, duke vlerësuar dallimet dhe duke i mirëpritur ato.
- **Bashkëpunimi dhe partneriteti:** Akademia vlerëson partneritetin dhe bashkëpunimin si mënyra më efektive për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të saj, duke qenë e hapur për bashkëpunim akademik dhe shkencor, me institucione publike dhe private, lokale dhe ndërkombëtare, në fusha dhe projekte me interes të përbashkët, gjithmonë duke garantuar shprehjen e lirë të ideve dhe duke siguruar stafin dhe studentët me mundësi të barabarta për punë dhe studim.
- **Inovacioni:** Akademia është e hapur për ndryshim, adaptim, veprim pro-aktiv dhe inovacion në punën e saj të përbashkët për të gjetur metoda të reja për të përmbushur sfidat në një mjedis gjithnjë në ndryshim.
- **Përsosmëria:** Akademia ka pritje të mëdha për veten e saj, studentët tanë dhe komunitetet tona, prandaj synon të përmirësojë vazhdimisht cilësinë e shërbimeve të saj bazuar në parimin e Akademizmit, transparencës dhe pavarësisë.

Fushat e intervenimit

1. **Udhëheqja dhe menaxhimi:** Ndarja e përgjegjësi, procedurat dhe rregulloret, organogrami, financimi, zhvillimi dhe menaxhimi i personelit, menaxhimi në organizatë, administrata, komunikimi i brendshëm.
2. **Mësimdhënia dhe sigurimi i cilësisë:** Sistemi për sigurimin e cilësisë, kurrikulat, puna praktike, promovimi akademik e profesional, metodologjia e mësimdhënies, vlerësimi i studentëve, vlerësimi nga studentët, zyra për SC.
3. **Hulumtimi:** projektet shkencore, integrimi i hulumtimeve në mësimdhënie, ekspertizat, programet e aftësisë.
4. **Bashkëpunimi dhe komunikimi:** mobiliteti, marrëdhëniet me publikun, komunikimi i brendshëm, marrëveshjet me IAL, projektet në IAL, marrëveshjet për punë praktike, bordet industriale, promovimi, strategjia e komunikimit, zyra për PR.
5. **Infrastruktura:** objektet, hapësirat, inventari dhe pajisjet, digjitalizimi, SEMS-i, laboratorët, teknologjia dhe mjetet mësimore.
6. **Çështjet studentore:** shërbimet studentore, mobilitetet studentore, zyra për K.Karrierë, bursat, shërbimet për përmirësimin e performancës.

Objektivat strategjike

OS 1 Menaxhimi dhe udhëheqja:

Të sigurohen procese efikase menaxhuese në funksion të ngritjes së performancës dhe të avancimit të shërbimeve në Akademia.

OS 2 Mësimdhënia dhe sigurimi i cilësisë:

Të zhvillohet metodologjia e mësimdhënies dhe proceset e sigurimit të cilësisë për përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe formimin e të diplomuarve të gatshëm për jetë e për tregun e punës.

OS 3 Hulumtimi

Të përkrahen nismat për hulumtime të aplikuara shkencore në shërbim të cilësisë së studimeve, zhvillimit akademik të personelit dhe të industrisë e shoqërisë.

OS 4 Bashkëpunimi dhe komunikimi

Të zhvillohen komunikimi dhe bashkëpunimi me entitete vendore e ndërkombëtare për ndërtimin dhe avancimin e imazhit të Akademisë dhe për ofrimin e mundësive të reja për studime, punë akademike dhe shërbime komunitare.

OS 5 Infrastruktura dhe digjitalizimi:

Të sigurohen kushtet më të mira me hapësirë mundësuese për studim, hulumtim, socializim të mundshme për punë e studime nëpërmjet të objekteve të reja, teknologjive dhe laboratorëve më bashkëkohore.

OS 6 Çështjet studentore:

Të zhvillohen dhe avancohen shërbimet dhe përkrahja studentore me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së studentëve dhe për krijimin e një mjedisi mundësues të studimit.

Plani strategjik

Në vijim, në pjesën e planit strategjik, paraqiten objektivat strategjike dhe masat përkatëse për arritjen e objektivave në funksion të realizimit të misionit të Akademisë.

Përshkrimi i objektivave

1. Menaxhimi dhe administrata
1.1. Vendosin një menaxhim dhe administrim efektiv për të mbështetur proceset akademike dhe kërkimore Institucionale
Për qëllim të mbështetjes së proceseve akademike dhe kërkimore, Akademia do të përqendrohet në zhvillimin e resurseve njerëzore (personeli i kualifikuar), rregulloret e procedurat dhe avancimi i kushteve të punës. Zhvillimi do të realizohet duke krijuar komisione, hartohet plani i zhvillimit, krijohet korniza për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit. Grupi punues i formuar për këtë qëllim do të funksionojë në bashkëpunim me të gjithë partnerët dhe palët e interesit.
1.2. Sigurimi i mbështetjes së shtuar për procedurat transparente dhe pjesëmarrëse të sigurimit të cilësisë
Një nga elementet që Akademia planifikon të punoj është kultura e cilësisë, e cila do të jetë shtylla kryesore e të gjitha përmirësimeve të Akademisë. Kjo do të arrihet përmes përfshirjes së të gjitha palëve në këtë proces (përfshirë por pa u kufizuar në stafin, studentët, palët e jashtme të interesit, etj) dhe transparencës në proceset dhe rezultatet e të gjithë sigurimit të cilësisë.
1.3. Përparoni kushtet e punës dhe krijoni një kulturë të përsosmërisë, inovacionit dhe përdorimit të teknologjive të reja në mënyrë që të zhvilloni cilësinë e shërbimeve arsimore dhe kërkimore
Me qëllim të mbështetjes së kulturës së inovacionit, përsosmërisë dhe zhvillimit të vazhdueshëm të stafit të saj në mësimdhënie dhe kërkime, Akademia do të mbështesë aktivitetet e stafit të saj në: - Bursë për trajnimin e stafit - Bursat për zhvillimin profesional në fushën e didaktikës dhe IT - Fondi për udhëtime studimore dhe lëvizshmëri - Fondi për pjesëmarrje në ngjarje akademike dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit - Aktivitete për të mbështetur promovimin e stafit - Mbështetja e zhvillimit akademik përmes lejeve për mungesë (sa-batikal) dhe të tjera.
1.4. Procedurat, planet dhe rregulloret

Zhvillimi dhe zbatimi i programit për ndryshimin dhe plotësimin e procedurave dhe rregulloreve. Në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm, staf akademik dhe administrativ, përfaqësuesit e menaxhmentit të Akademisë, Zyra Ligjore do të organizojë një punëtori tre ditore për hartimin e rregulloreve, planeve dhe procedurave të Akademisë. Puna do të përfundojë në tre faza: faza e parë është analizimi i nevojave për rregullore të reja të gjetura në reformimin e organogramit të Akademisë; faza e dytë e grupit të punës deri në prezantimin e draftit të parë, dhe faza e tretë, miratimi dhe nënshkrimi i rregulloreve të versionit përfundimtar. Procedura që do të ndiqet për të krijuar draftin e parë do të jetë një sistem i dyfishtë, një model i marrë nga modelet e jashtme dhe nevojat dhe kërkesat e gjetura në raportin e ekspertëve, nevojat e Akademisë dhe idetë që e lidhin atë me procesin e punës. E gjithë puna për krijimin dhe përpunimin e rregulloreve do të bazohet në kritere ligjore, d.m.th. bazuar në rregulloret e BE-së, Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Strategjinë e Akademisë.

1.5. Baza e të dhënave për tregun e punës

Me qëllim të marrjes së informacionit të vazhdueshëm dhe të besueshëm mbi nevojat dhe tendencat e tregut, do të krijohet ekipi që do të përfshinte menaxhmentin, industrinë, stafin e Akademisë. Ekipi do të themelohet si një njësi e përhershme, e cila bashkëpunon me të gjithë aktorët e interesuar për nevojat e tregut në programet e studimit. Ekipi administron:

- Pyetësorë dhe kryen një hulumtim mbi nevojat e tregut (industria e synuar, universitetet, kolegjet, shkollat dhe studentët),
- Hulumtimi i raporteve ekzistuese të (UNDP, Banka Botërore, Agjencia e Statistikave, Agjencia e Punësimit e Kosovës, etj.)
- Kërkime në terren: vizita studimore në institucionet e arsimit të lartë, industri dhe institucione të tjera publike dhe private.
- Një bazë e të dhënave do të krijohet dhe azhurnohet rregullisht për trendet e tregut dhe nevojat në fushat përkatëse, si dhe bashkëpunimin dhe veprimin me ekipin e krijuesve të programeve në Akademi.

Treguesit kryesorë të performancës

- Hartimi i rregulloreve,
- Miratimi i rregulloreve,
- Numri i mobiliteteve akademike dhe aktiviteteve të tjera shkencore të realizuara nga stafi,
- Numri i punëtorive për zhvillimin e stafit
- Krijimi i bazës së të dhënave për tregun e punës.

Caqet

- Draftimi i rregulloreve kryesore deri me 31 dhjetor 2020;
- Aprovimi i rregulloreve deri me 10 janar 2021;
- Draftimi i rregulloreve tjera deri me 31 mars 2021;
- Pjesëmarrja e së paku 5 mësimeve në mobilitete akademike deri në vitin 2023;
- Organizimi i së paku një aktiviteti për zhvillimin e stafit akademik në vit;
- Krijimi i bazës së të dhënave për tregun e punës.

2. Mësimdhënia dhe sigurimi i cilësisë

2.1. Vendosni një menaxhim dhe administratë efektive për të mbështetur proceset akademike dhe kërkimore

Në mënyrë që të mbështesë mësimdhënien midis stafit të saj, akademia do të vendosë:

- HR dhe zyra e zhvillimit të kryer, dhe
- Mbështetja e fondeve për zhvillimin profesional të stafit

2.2. Sigurimi i mbështetjes së shtuar për procedurat transparente dhe pjesëmarrëse të sigurimit të cilësisë

Akademia do të përdorë reagimet nga aktivitetet e SC dhe do të vendosë procedurat e vetë-reflektimit të stafit të saj mësimor për të përmirësuar procesin e saj të mësimdhënies dhe të të nxënit. Ky proces do t'i sigurojë stafit të tij mjetet për të kryer vetëvlerësim dhe reflektim aty ku do t'i jepej ndjenja e pronësisë në zhvillimin e tyre në të ardhmen. Ky duhet të jetë një proces transparent dhe do të rregullohet brenda me rregulloren, politikat dhe proceset e tij.

2.3. Zhvillimi i personelit, cilësia e shërbimeve arsimore dhe kërkimore në krijimin e kulturës së ekselencës

Zbatimi i aktiviteteve nga rregullorja për sigurimin e cilësisë. Akademia do të kushtojë rendësi të veçantë procesit të monitorimit të vazhdueshëm, duke përfshirë: monitorimin në mësimdhënie (përmes vlerësimit të studentëve, kolegut dhe menaxherit), infrastrukturën (vlerësimi nga studentët dhe stafi), administratën (vlerësimi nga studentët dhe stafi), punësimin të studentëve (vlerësimi nga alumni dhe të diplomuarit), efektin e programit (vlerësimi me student, Alumni, të diplomuarit dhe bizneset/punëdhënësit).

Aktivitetet

- Hartimi i programit të zhvillimit të personelit;
- Zbatimi i Planit duke ndarë fonde për trajnime, vizita studimore, financime për kërkime publike etj.
- Vlerësimi i performancës së personelit
- Vlerësimi i ndikimit të planit të zhvillimit të personelit
- Rezultatet e programit dhe komisionit do të publikohen në platformën online.

Aktivitetet:

- Mbështetja në formën e këshillimit në karrierë;
- Bashkëpunimi në hulumtime duke integruar hulumtimet në programet e studimit dhe të mësuarit;
- Hartimi i instrumenteve për vlerësimin e nevojave të mentorimit të studentëve
- Vlerësimi i nevojave dhe implementimi i mentorimit;
- Vlerësimi efektiv i mentorimit të studentëve
- Organizimi i aktiviteteve shtesë mësimore (përgatitja për teste, mbështetja për përgatitjen e prezantimeve, mbështetja për projektet e arsimit të studentëve, sigurimi i teknologjisë për kryerjen e detyrave, sigurimi i klasave për mësimdhënie jashtë orarit të rregullt të punës, forcimi i shërbimeve të bibliotekës, etj.
- Organizimi i vizitave studimore në vend, rajon dhe Evropë.

2.4. Hartimi i programeve të studimit

Programet e Studimit do të hartohen dhe avancohen bazuar në nevojat e tregut dhe praktikat më të mira ndërkombëtare (prirjet e tregut ndiqen, hartohen programe të reja (sa programe në vit), programet e përbashkëta me institucionet ndërkombëtare akreditohe, zbatohen dhe hartohen) Aktivitetet:

- Përcaktimi i grupit të punës për rishikimin dhe hartimin e programeve të studimit;
- Hulumtimi i tregut dhe bashkëpunimi me industrinë përkatëse;
- Miratimi nga grupi i punës;
- Kërkesa për akreditim;
- Promovimi i programeve të reja të studimit.
- Zbatimi.

2.5. Sistemi i Sigurimit të Cilësisë

Zbatimi i aktiviteteve nga Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë. Akademia do t'i kushtojë një rëndësi të veçantë procesit të monitorimit duke përfshirë: vlerësimin e mësimdhënies (nga studentët dhe kolegët), infrastrukturën (vlerësimin nga studentët dhe stafi), administrimin (vlerësimin nga studentët dhe stafi), punësimin e studentëve (vlerësimin nga alumni dhe të diplomuarit), programin (vlerësim me studentë, alumni, të diplomuar dhe biznese / punëdhënës).

Aktivitetet:

- Zhvillimi dhe implementimi i instrumenteve (pyetëtori, protokollet, udhëzimet, rregulloret, etj.) Për sigurimin e cilësisë.
- Hartimi i Udhëzuesit për Sigurimin e Cilësisë si pjesë e rregullores së SC (përfshin: strukturën e SC, procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, procedurat e ankesave të studentëve, etj.);
- Plani vjetor i punës për zhvillimin e cilësisë;
- Ndërtimi i kapaciteteve për sigurimin e cilësisë.

2.6. Shërbime këshilluese për transportuesit

Akademia synon të orientojë studentët (por edhe të rinjtë e tjerë) në karrierën e tyre, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë personale të kërkuara nga bizneset ose institucionet, si dhe të gjejnë punë praktike me mundësi punësimi.

Aktivitetet:

- Këshillim individual dhe në grup për udhëzime në karrierë;
- Mbështetja e studentëve dhe të diplomuarve për aplikim për punë;
- Organizimi i kurseve për hartimin dhe hartimin e një biografie, përgatitja për intervista, zhvillimi i aftësive themelore, komunikimi, etj;
- Informacion mbi kërkesat e tregut (vendet e lira);
- Mirëmbajtja dhe azhurnimi i rregullt i statistikave në lidhje me punësimin e të diplomuarve.

2.7 Ndërlidhja e kurrikulës me industrinë

Përfshirje më e mirë e industrisë në funksionim të Akademisë (marrëveshje, këshilla industriale, punëtori, ngjarje të përbashkëta, aplikim i përbashkët për projekte, pjesëmarrje në rishikimin dhe hartimin e planprogrameve, etj.)

Aktivitetet:

- Hartimi i rregullores së Këshillit të Partnerëve;
- Mbështetje për aktivitetin ose Këshillin e Partnerëve;
- Organizimi i aktiviteteve të bashkëpunimit me institucionet dhe kompanitë në lidhje me praktikën profesionale dhe mundësitë e punësimit;
- Kontributi i anëtarëve të Qendrës në rishikimin e programeve të studimit dhe zhvillimin e programeve të reja;

2.8. Integrimi dhe organizimi i praktikës dhe të mësuarit në punë

Organizimi i aktiviteteve të praktikës për studentët, përfshirë monitorimin, vlerësimin dhe çertifikimin e praktikës. Që nga semestri i dytë e tutje, praktika dhe hulumtimi do të përfshihen në modulet kryesore të kurrikulës. Nga ana tjetër, që nga semestri i gjashtë i studimeve, do të përfshihet praktika profesionale e studentëve për një periudhë më të gjatë dhe më të përqendruar në institucione / kompani përkatëse, në varësi të programeve të studimit.

Aktivitetet:

- Hartimi i Rregullores për Praktikën;
- Përfshirja e praktikës në programet mësimore
- Intensifikimi i vizitave studimore nga semestrat 1-5;
- Mbikëqyrja nga stafi dhe mentori në drejtim të zbatimit të praktikës profesionale;
- Raporti i mbikëqyrësit të studentit për performancën;
- Ditari i studentit për praktikën;
- Miratimi i ditarit të punës nga Koordinatorin e Programit.

2.9. Avancimi i mësimdhënies

Zhvillimi dhe zbatimi i programit për mësimdhënie cilësore (trajnim në metodologji, përfshirje të fushave pedagogjike dhe profesionale në kriteret e promovimit akademik). Zhvillimi i sistemit arsimor të bazuar në cilësi në një qasje më gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënie do të mundësojë formimin e individëve në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare

Aktivitetet:

- Pjesëmarrja në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Publikimi i punimeve shkencore;
- Pjesëmarrja në tryezat e rumbullakëta dhe projektet profesionale;
- Kontributi për shoqërinë;
- Trajnime profesionale dhe vizita studimore;
- Lëvizshmëria.

Treguesit kryesorë të performancës

- Akreditimi i programeve të reja të studimit
- Gatishmëria e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për të marrë pjesë në proceset e sigurimit të cilësisë në Akademi,
- Realizimi i aktiviteteve të karrierës për studentët, drejt zhvillimit të tyre profesional,
- Realizimi i punës praktike të studentëve
- Nivel i lartë i performancës së stafit akademik
- Përfshirja e bizneseve në hartimin e programeve të studimit

Caqet

Akreditimi i të paktën dy programeve të reja të studimit në 2021

- Akreditimi i të paktën pesë programeve të reja të studimit në 2025
- Përfshirja e të paktën 5 bizneseve në hartimin e programeve të studimit,
- Zbatimi i të paktën katër aktiviteteve për zhvillimin e karrierës studentore çdo vit,
- Çdo student i vitit të tretë përfundon punën praktike
- 80% e stafit tregojnë performancë të pranueshme për çdo vit

3. Hulumtimet shkencore

3.1 Vendorsni një menaxhim dhe administrim efektiv për të mbështetur proceset akademike dhe kërkimore

Akademia do të mbështesë proceset kërkimore në dy aspekte:

- Ndërtimi i kapaciteteve në shkencë, dhe
- Ndërtimi i kapaciteteve në raportim

Ndërtimi i kapaciteteve në shkencë

Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin, zbatimin dhe menaxhimin e projekteve shkencore për fondet kombëtare dhe ndërkombëtare. Kërkimi i zbatuar i aspekteve të rëndësishme për shoqërinë dhe ekonominë do të jetë një nga përparësitë kryesore të Akademisë gjatë periudhës së planifikuar. Për ta bërë këtë, ekziston nevoja për të zhvilluar kapacitete në hartimin dhe menaxhimin e projekteve shkencore të aplikuara.

Aktivitetet:

- Zhvillimi i një programi të zbatueshëm për kërkimin shkencor dhe menaxhimin e projekteve profesionale për fondet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Krijimi i kushteve fizike dhe motivimi i personelit për t'u përfshirë në projekte ndërkombëtare
- Zhvillimi i rregullores për pjesëmarrjen e projekteve kërkimore ndërkombëtare (ndarja e përgjegjësive dhe përfitimeve ndërmjet institucionit dhe stafit akademik të përfshirë në projekte shkencore);
- Mbështetje për personelin për pjesëmarrje në ngjarje ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve në hartimin, menaxhimin dhe raportin e rezultateve të projekteve kërkimore;
- Organizimi i trajnimit të personelit në fushën e:
 - a) Hulumtimi i programeve dhe fondeve që mbështesin kërkimin shkencor
 - b) Krijimi i partneriteteve për kërkimin shkencor
 - c) Hartimi i projekteve shkencore,
 - d) Menaxhimi i projekteve shkencore

Vlerësimi i ndikimit të programit të trajnimit në fushën e projekteve shkencore për qëllim të mbështetjes së proceseve akademike dhe kërkimore, Akademia do të përqendrohet në zhvillimin e burimeve njerëzore (personel të kualifikuar), rregulloret dhe procedurat dhe avancimin e kushteve të punës. Zhvillimi do të kryhet duke krijuar komisionin, duke hartuar planin e zhvillimit, krijohet korniza për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit.

Grupi i punës i formuar për këtë qëllim do të funksionojë në bashkëpunim me të gjithë partnerët dhe palët e interesit.

Ndërtimi i kapaciteteve në raportim

Ndërtimi i kapaciteteve për të raportuar zbatimin e projekteve shkencore. Raportimi i të dyve, rezultatet e hulumtimit dhe zbatimi i projekteve kërkimore. Për këtë qëllim, duhet të ketë një zhvillim të udhëzimeve përkatëse, si dhe aftësive për të shkruar raport, monitorim dhe vlerësim ose projekte, në përputhje me treguesit e zhvilluar paraprakisht. Një nga përmbajtjet e trajnimit duhet të jetë hartimi i kornizës së monitorimit dhe performancës.

Aktivitetet:

- Zhvillimi i udhëzimeve për metodën e raportimit të zbatimit të hulumtimeve dhe projekteve të aplikuara, të cilat supozohet të zbatohen nga stafi akademik;
- Zhvillimi i udhëzuesit për vlerësimin e cilësisë së projekteve shkencore.
- Zhvillimi i një sistemi për vlerësimin e punës shkencore;
- Trajnimi i personelit në përputhje me udhëzimet për raportimin.

3.2. Zhvillimi i cilësisë së shërbimeve kërkimore në krijimin e kulturës së përsosmërisë së personelit

Programi për Mbështetjen e Personelit në Zhvillimin Shkencor do të hartohet dhe zbatohet. Akademia do të miratojë Programin për mbështetjen e botimeve si një burim financimi për të mbuluar shpenzimet për personelin akademik dhe studentët e Akademisë për botim në revistat ndërkombëtare.

Financimi duhet të jetë i disponueshëm mbi bazën e konkurrencës duke siguruar transparencë të plotë. Qëllimi i këtij Programi është të sigurojë një pjesëmarrje të zgjeruar në rrjetet ndërkombëtare të kërkimit. Sigurimi i hyrjes për studiuesit në bibliotekat përkatëse elektronike (p.sh. Thomson Web of Knowledge; SCOPUS etj.) Një nga masat e Programit është krijimi i revistës shkencore të Akademisë, e cila do të publikojë rezultatet e kërkimit bazë dhe të aplikuar, të bëra nga studiuesit e Akademisë dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë.

Aktivitetet:

- Zhvillimi i programit dhe kostot e aktiviteteve të tij për botimet në revistat e huaja akademike, të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht dhe kanë pasur ndikim në fushat e tyre;
- Alokimi i fondeve për të kryer programin për mbështetjen e shkencës.
- Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara për botimin e një numri të konsiderueshëm të botimeve shkencore në revistat ndërkombëtare dhe për pjesëmarrjen në konferenca dhe ngjarje shkencore;
- Krijimi i revistës shkencore të Akademisë (përfshirë Këshillin e Publikimit me anëtarë ndërkombëtarë)
- Efektet e programit do të monitorohen duke vlerësuar progresin e portofolit të secilit anëtar të personelit.

3.3. Konferencat ndërkombëtare

Hartohet dhe zbatohet programi i konferencave ndërkombëtare. Akademia do të organizojë së paku një konferencë ndërkombëtare në vit në fushën e trafikut, transportit dhe sigurisë rrugore. Qëllimi është që Akademia të bëhet pikë reference në rajon për trendet më të avancuara në fushën e kërkimeve në trafik. Për këtë

qëllim do të krijohet një trupë e përhershme - Këshill Organizativ. Në përbërje të Këshillit do të ketë edhe ekspertë të nga institucione të tjera të arsimit të lartë në Kosovë e në rajon.

- Në kuadër të planit të shkencor, të hartohet programi për organizimin dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare;
- Organizohet së paku një konferencë ndërkombëtare në vit, në të cilën bartës do të jetë Akademia;
- Konferenca organizohet në bashkëpunim me institucione të afirmuara të arsimit të lartë dhe të shkencës në nivel vendi, rajonal dhe më gjerë (kryesisht me institucione të ndryshme të arsimit të lartë me të cilat Akademia ka bashkëpunim);
- Në mënyrë të veçantë, konferenca fokusohet në problemet të cilat, kryesisht, bien nën kompetencën e fushave të ndërlidhura me trafikun dhe transportin (siç janë siguria në trafik, logjistika e transportit, planifikimi i trafikut dhe transportit, siguria rrugore, etj).

3.4. Ngritja e kapaciteteve për analiza dhe ekspertiza

Forcohen kapacitetet për kryerjen e analizave dhe ekspertizave të aksidenteve në trafik. (përfshirë rregulloren për përfitime nga ekspertizat e kryera). Akademia do të krijojë një grup pune për të përgatitur rregulloren për përfitime nga ekspertizat e kryera. Njëkohësisht do të avancohet bashkëpunim me institucione të cilat kanë interes për ekspertiza profesionale nga fusha e trafikut dhe transportit (Gjykatat, Kompanitë e sigurimeve, partnerëve dhe autoriteteve të ndryshme).

Pastaj do të ofrohet mbështetje për zhvillimin kapaciteteve për kryerjen e ekspertizave dhe projekteve të përbashkëta profesionale. Në këtë mënyrë, Akademia do të inkurajojë pjesëmarrjen e stafit akademik në ekspertiza dhe projekte profesionale me institucione të ndryshme, kryesisht bazuar në marrëveshjet e Akademisë me institucione të ndryshme.

Aktivitetet:

- Hartohet programi për ngritjen e kapaciteteve për ekspertiza;
- Nënshkruhen marrëveshje për kryerjen e ekspertizave;
- Zbatohet programi (punëtori për aspekte të ndryshme të ekspertizave si planifikimi, zbatimi, raportimi);
- Vlerësohet programi.

3.5. Zbatimi i hulumtimeve të aplikuara

Rritja e bashkëpunimit për hulumtime të aplikuara

Aktivitetet:

- Hartohet koncepti për hulumtime të aplikuara në fushat prioritare të Akademisë;
- Krijimi i grupeve punuese për hulumtime të aplikuara në bazë të profileve dhe fushave prioritare;
- Përpilohet një listë e projekt-ideve të hulumtimeve të aplikuara dhe u dërgohet partnerëve dhe autoriteteve;
- Krijohet dhe publikohet portofoli i Akademisë për hulumtime të aplikuara, analiza dhe për ekspertiza;
- Zbatohen projekte të hulumtimeve të aplikuara.

3.6. Partneritetet vendore për hulumtime

Forcimi i partneriteteve në fushën e hulumtimeve shkencore (bazë dhe të aplikuara). Rritja e bashkëpunimit mes Akademisë dhe universiteteve publike dhe bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë me qëllim të rritjes së bashkëpunimit shkencor. Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore do të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Aktivitetet:

- Thirrje institucioneve në Kosovë dhe në rajon aktive në shkencat teknike për forcim të partneriteteve;
- Nënshkrim i memorandumit për bashkëpunim me institucionet përkatëse;
- Zbatimi i aktiviteteve dhe të përgjegjësve nga memorandumit i nënshkruar.

Treguesit Kryesorë të Performancës

- Numri i projekteve të përbashkëta vendore dhe ndërkombëtare hulumtuese;
- Numri i punimeve kërkimore të stafit akademik dhe studentëve të Akademisë të publikuara në revista ndërkombëtare si bashkë-autorë;
- Pjesëmarrja në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, ku do të shfaqen njohuritë e fituara praktike, përmes hulumtimeve të ndryshme;
- Numri i ekspertizave shkencore të realizuara nga stafi i Akademisë;
- Organizimi i suksesshëm i konferencave ndërkombëtare;
- Thellimi i bashkëpunimit ndërmjet mësimitdhënësve në punët e tyre kërkimore shkencore.

Caqet

- Së paku një bashkëpunim në vit me partnerë vendor dhe ndërkombëtar në projekte të përbashkëta shkencore;
- Mesatarisht një punim shkencor të publikuar nga secili staf akademik në vit;
- Pjesëmarrje në 1 konferencë ndërkombëtare në vit nga stafi akademik;
- Themelimi i fondit për kërkim në Akademia për përkrahje të punës hulumtuese të stafit dhe studentëve;
- Organizimi i së paku një konference në vit në bashkëpunim me institucionet, universitetet ndërkombëtare;
- Së paku pesë hulumtime dhe publikime të përbashkëta në mes të mësimitdhënësve të Akademisë.

4. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

4.1. Vendosja e një menaxhimi dhe administrimi efektiv për të mbështetur proceset akademike dhe kërkimore

Avancimi dhe promovimi i imazhit dhe vlerave të Akademisë (përshkruaj Logo, imazhi, historiku, vlerat, parimet, materialet promovuese.)

- Hartohet politika/rregullorja për ruajtjen dhe afirmimin e imazhit të Akademisë;
- Mishërohet stafi i Akademisë më imazhin, misionin dhe vlerat e Akademisë.

Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Themelimi i Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar, në mënyrë që të rritet cilësia dhe sasia e bashkëpunimit ndërkombëtar. Ndërtimi i kapaciteteve të IOM do të ndikojë në sasinë dhe cilësinë e bashkëpunimit në të gjitha fushat e bashkëpunimit.

Si pjesë e aktiviteteve ndërkombëtare me të cilat do të merret zyra për bashkëpunimin ndërkombëtar do të jenë:

- Identifikimi i partnerëve të mundshëm ndërkombëtarë
- Lehtësimi i nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare
- Organizimi-shkëmbimi i studentëve dhe stafit akademik,
- Ndihmon Akademinë në aktivitetet e përbashkëta ndërmjet Institucioneve Ndërkombëtare në:
 - a) punime / kërkime të përbashkëta shkencore
 - b) organizimi i konferencave të përbashkëta shkencore,
 - c) lëvizshmërinë e stafit akademik dhe studentëve,
 - d) d) konkurs i përbashkët në projekte ndërkombëtare, etj.

4.2. Rritja e mbështetjes në cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimeve kërkimore në krijimin e kulturës së ekselencës dhe inovacionit

Marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim dhe lëvizshmëri

Zhvillimi, nënshkrimi dhe implementimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për bashkëpunim.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në Akademi, duke krijuar renditjen e mëposhtme të aktiviteteve:

- identifikimin e fushave të bashkëpunimit,
- identifikimin e qëllimeve konkrete të bashkëpunimit,
- përcaktimi i kriterëve të lëvizshmërisë për studentët dhe stafin,
- monitorimin e lëvizshmërisë dhe rezultatet e tyre,
- zbatimin i ndryshimeve të nevojshme në lëvizjet (fushat, partnerët),
- rishikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara dhe propozimin për marrëveshje të reja.

Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin e projekteve ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit

Pjesëmarrja në punëtoritë e organizuara nga autoritetet dhe organizatat e tjera brenda dhe jashtë vendit Një nga objektivat e bashkëpunimit ndërkombëtar është rritja e kapaciteteve për të kryer kërkime dhe projekte industriale. Për këtë qëllim, ai i kushton vëmendje pjesëve kërkimore të projekteve duke aplikuar pajisje dhe teknologji gjatë zbatimit të lëvizjeve. Pjesëmarrja në prezantime ose punëtori për të adresuar çështje kërkimore kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e kapaciteteve të Akademisë. Ndërtimi i kapaciteteve do të arrihet përmes:

- organizimi i punëtorive për hartimin e projekteve ndërkombëtare,
- pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar nga institucionet dhe organizatat e vendit në vend dhe jashtë saj,

- duke përdorur përvojën e fituar nga lëvizjet e implementuara, zhvillimi i projekteve për kërkime.

4.3. Siguroni mbështetje të shtuar për procedurat transparente dhe pjesëmarrëse të sigurimit të cilësisë.

Programet e Komunitetit

Akademia zhvillon dhe zbaton një program dhe ekspertizë të shërbimit të komunitetit (shërbimet e komunitetit janë të përfshira në kontratat e personelit). Akademia do të vazhdojë të jetë e përkushtuar ndaj shërbimeve të komunitetit në fushën e sigurisë rrugore dhe përmirësimit të infrastrukturës rrugore me qëllim të akomodimit të të gjithë përdoruesve të trafikut.

Aktivitetet:

- Plani vjetor për kryerjen e aktiviteteve të sigurisë rrugore (konferenca, tryeza të rrumbullakëta, fushata, emisione televizive, hulumtime);
- Pjesëmarrja në projektin kombëtar "Siguria Rrugore" me shkollat themelore dhe të mesme të ulëta në të gjithë Kosovën.
- Bashkëpunim me Komunën e Prishtinës për implementimin e masave nga lëvizshmëria e qëndrueshme urbane.
- Negocimi dhe implementimi i marrëveshjeve me shkollat dhe komunat e tjera në Kosovë

Marketingu dhe marrëdhëniet me publikun

Në lidhje me marketingun, i cili është një nga pikat më të forta jo vetëm për ne, por edhe për të gjithë ata që kanë çdo lloj pune, menaxhojnë, sfidohen, por gjithashtu kanë suksese për të treguar punën e tyre. Në fillim, për shkak të kostos shumë të lartë që kërkon marketing i duhur, ne nuk do të përqendrohemi në të në këtë kohë, por duhet të bëjmë më shumë për këtë qëllim në të ardhmen.

Këshilli i partnerëve

Forcimi i partneriteteve me industrinë

- Këshilli i Partnerëve Që nga themelimi, Akademia i kushtoi vëmendje bashkëpunimit me bizneset, në të cilat studentët kryen praktikën profesionale. Prandaj, Akademia gjithashtu ka krijuar Qendrën për Inovacion dhe Sipërmarrje, e cila përbëhet nga anëtarët e institucioneve dhe bizneseve, me të cilët ne bashkëpunojmë. Përmes kësaj qendre, Akademia do të promovojë më shumë ndërveprime me biznesin dhe industrinë, duke përfshirë zhvillimin e vazhdueshëm profesional, kërkimin bashkëpunues, këshillimin, licencimin. Fokusi do të jetë gjithashtu puna me partneritete dhe në zhvillimin e aftësive dhe shërbimeve për të promovuar një rritje të qëndrueshme ekonomike inovative.

Aktivitetet:

- Kërkime
- Këshilla industriale,
- Punëtori,
- Projekte të përbashkëta,

4.4. Konkurrimi për projekte ndërkombëtare – Erasmus, Horizon, grante vendore

Projektet ndërkombëtare janë pjesë e veçantë e fokusit të Akademisë në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve në të gjitha fushat. Kjo do të realizohet përmes:

- partneritetit me institucione ndërkombëtare;
- konsorciume me institucione/kompani ndërkombëtare;
- identifikimi i projekteve me interes në fushat e Akademisë,
- identifikimi i partnerëve të përshtatshëm me projektin;
- përpilimi i marrëveshjes/partneritetit/konsorciume;
- studimi i përmbajtjes së projektit;
- aplikimi.

4.5. Partneritete e rrjetëzime ndërkombëtare

Me realizimin e marrëveshjeve dhe zbatimin e tyre, matja e rezultateve të arritura është një ndër detyrat e rëndësishme në kuadër të Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Pjesë e vlerësimit të marrëveshjeve të realizuara është vazhdimi i bashkëpunimit në forma tjera më partnerët:

- anëtarësimi në asociacione për siguri rrugore;
- vlerësimi i përbashkët i rezultateve të marrëveshjeve të bashkëpunimit;
- sigurimi i përkrahjes financiare (projekte të përkrahjes);
- zgjerimi i fushave të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtare.

4.6. Bashkëpunimi me shkollat

Sa i përket bashkëpunimit me shkolla lidhur me aktivitetet për sigurinë rrugore stafi i tanishëm i Akademisë, do të realizoj aktivitete hulumtuese që do të zhvillohen me shkollat nga cikli i ulët deri te ato të nivelit të lartë në shkollat nga të gjitha komunat në shkallë vend. Pyetësorët do të ju ofrohen për të hulumtuar njohurit prej atyre bazike sa i përket njohurive mbi rregullat n trafikun rrugor.

Nga këto hulumtime ka dale qe ashte rritur vetëdisimit i nxënësve ne këtë pike por me gjithat duhet bere ende ne këtë drejtim. Për me tepër kërkesa jone ishte dhe ashte sidomos karshi Ministrisë se Arsimit dhe Shkences qe te beje te mundur te hynë ne plan program si lende mësimore Njohurit mbi rregullat ne trafikun rrugor nga kopshtet e tutje (te gjitha nivelet e shkollimit).

Me qëllim të rritjes së kualitetit dhe performancës së nxënësve nga shkollat e mesme (evidentuar si dobësi përgatitja e nxënësve nga shkolla e mesme), duhet të rritet bashkëpunimi me shkollat e mesme, profili i të cilave mundëson që të jenë student të ardhshëm të Akademisë. Ngritja e performancës do të realizohet:

- informimi i mësimdhënësve për pikat e dobëta të studentëve nga shkollat e mesme;
- organizimi i kurseve përgatitore në fusha të caktuara;
- organizimi i kurseve për përvetësimin e gjuhëve të huaja (gjermane, angleze).

Treguesit Kryesorë të Performancës

- Identifikimi i stafit dhe studentëve me Misionin, Vizionin dhe Vlerat e Akademisë;
- Anëtarësimi së paku në një nga asociacionet ndërkombëtare të universiteteve ;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve me institucione ndërkombëtare;
- Aplikimi në projekte ndërkombëtare;
- Partner në projekte ndërkombëtare të llojit Erasmus+, etj.
- Shkëmbimi i studenteve, stafit me universitetet ndërkombëtare;
- Numri i ligjëruesve mysafir (guest lecturer) në Akademia;
- Aktivitete me shkolla në Kosovë;
- Realizimi i aktiviteteve në komunitet.

Caqet

- 90% e stafit dhe 80% e studentëve identifikojnë Misionin dhe Vlerat e Akademisë;
- Anëtarësimi në një nga asociacionet e universiteteve në vitin e parë të implementimit
- Nënshkrimi i së paku një marrëveshje ndërkombëtare në vit;
- Aplikim si partner në së paku një projekt Erasmus+ në secilin vit;
- Hartimi i së paku dy projekt propozimeve në projekte ndërkombëtare deri në fund të vitit 2024;
- Pjesëmarrja e së paku 3 mësimitdhënësve dhe studentëve në mobilitete ndërkombëtare (në shkuarje dhe ardhje) deri në fund të vitit 2024;
- Pjesëmarrja së paku një mësimitdhënësi ndërkombëtar në ligjërata me student dhe staf akademik të Akademisë deri në fund të vitit 2024;
- Organizimi i së paku një aktiviteti me shkolla të Kosovës në vit;
- Së paku dy aktivitete të realizuara në komunitet.

5. Infrastruktura e digjitalizimi

5.1 Krijoni një infrastrukturë efektive teknologjike dhe ekzistuese fizike për të mbështetur proceset akademike dhe kërkimore Avancimin teknologjik dhe ekzistues të infrastrukturës fizike

Zyra për tekonojgi dhe operacione, do të kujdeset dhe do të krijoj mekanizma të cilat kanë si qëllim që hapësirat fizike të Akademisë të jenë në përputhshmëri me trendët e reja në sferën e teknologjisë arsimore. Përmirësimi i bazës teknologjike në Akademia-n është proces i vazhdueshëm që nga nisja e punës në vitin 1992 me programe aftësuese dhe trajnime.

Në fushën e infrastrukturës Akademia do të angazhohet në këto aktivitete:

- Krijimi i hapësirës së bibliotekës, dhe efektiviteti i qasjes në literaturën shkencore, mësimitdhënie dhe literaturë profesionale dhe bazat e të dhënave. Vazhdimi i plotësimit me libra dhe revista të reja dhe sigurimi i qasjes në bazat e të dhënave shkencore dhe profesionale në përputhje me nevojat e stafit akademik dhe studentëve. Planet vjetore për blerjen e librave dhe revistave dhe sigurimin e qasjes në bazat e të dhënave shkencore dhe profesionale;
- Krijimin e hapësirës për lexim për student;
- Gjetja e fondeve dhe ndarja e linjave buxhetore për ofrimin e burimeve të disponueshme, si dhe do ta rrisim infrastrukturën që mbështet hulumtimet në nivelin më të lartë, duke përfshirë bibliotekat dhe sistemet e informacionit.

5.2. Përparimi i kushteve të punës dhe krijimi i një kulture të përsosmërisë, inovacionit dhe përdorimit të teknologjive të reja në mënyrë që të zhvillojë cilësinë e shërbimeve arsimore dhe kërkimore

- Zgjerimi dhe avancimi i shërbimeve laboratorike;
- (Pajisja e laboratorëve të tjerë dhe ripërtirja e pajisjeve të tanishme);
- Avancimi i aktiviteteve laboratorike në fushën e punës kërkimore shkencore;
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i pajisjeve laboratorike dhe sigurimi i burimeve njerëzore me qëllim të punës kërkimore shkencore, forcimi i rolit të laboratorëve në mësimdhënie dhe në zbatimin e hulumtimeve në programet e reja studimore;
- Marrëveshja bashkëpunimi me Kompani dhe Institucione të cilat posedojnë laboratorë, servise, punishte dhe park vozitës ku mund të shfrytëzohen për punë praktike për studentë dhe kursantë në trajnime tjera;
- Rritja e përdorimit të laboratorëve nga ana e personelit akademi dhe studentëve për punë kërkimore dhe shkencore dhe ofrimi i laboratorëve për doktorantët e rinj dhe nevojat e institucioneve publike dhe private, rezultatet e të cilit do të ishin për interesat e vendit dhe më gjerë;
- Pajisjet laboratorike:
 - * Softuer për modelimin e aksidenteve rrugore;
 - * Softuer për ngasjen e sigurt për drejtim ;
 - * Softuer për ngasjen ekonomike (ECO-ngasja);
 - * PC për ushtrime speciale dhe trajnime në transport;
 - * Automjet special për ushtrime praktike (ushtrimet për rripin e sigurisë);
 - * Pajisjet mobile mjekësore për ofrimin e ndihmës të parë në rast aksidenti të trafikut apo në rast të rreziqeve tjera.

5.3. Baza e të dhënave për tregun

Me formimin e Këshillit të Partnerëve do të hapet mundësi e mirë e bashkëpunimit dhe çuarjes përpara të procesit sigurimit të dhënave të nevojshme për tregun e punës. Pos kësaj Akademia do të krijojë një data bazë të veçantë për futjen dhe përditësimin e të dhënave për nevojat e tregut për profesionet relevante të tregut. Informacionet e mbledhura do të përdoren për informimin e studentëve, të diplomuarve por edhe gjatë procesit të hartimit të kurrikulave të reja ose gjatë rishikimit të tyre të rregullt vjetor.

Aktivitetet:

- Krijohet dhe përditësohet rregullisht një bazë e të dhënave për trendët dhe nevojat e tregut të punësimit në fushat përkatëse;
- Ndërtohet ura lidhëse mes institucionit dhe bizneseve;
- Krijohen ndërlidhje (interface) me data bazat e Agjencisë së Punësimit të Kosovës dhe me Agjencinë e Statistikave të Kosovës
- Ofrohen të dhënat edhe për institucione të tjera.

5.4. Ndërtimi i kampusit të ri të Akademisë

Me rastin e festimit të 30 vjetorit të Tempullit, do të bëhet edhe përrurimi i Kampusit të ri Inovativ.

Lokacioni i për ndërtimin e Kampusit është në pjesën e re të qytetit, në Lagjen e Spitalit e lidhur me rrugët më të gjera të qytetit të Prishtinës, rrugët A, B dhe C. Programi urbanistik është i aprovuar dhe ka filuar faza e parë e ndërtimit të kompleksit. Ky kampus i ri krijon kushtet më të mira fizike të punës (ndërtimi i objektit të ri, plani, ndërtimi, pajisjet, laboratorët, inventari, etj.).

- Planimetritë e Infrastrukturës teknike ekzistuese, kërkesat dhe Punët;
- Kycje në infrastrukturën teknike të qytetit.
- Aktivitetet inxhinierike;
- Projektet e enterierit, kopshtit, infrastrukturës teknike të oborrit, pllatove, mureve mbrojtëse, shkallëve të jashtme, rampave-pjerrinave, sigurimi I gropës ndërtimore;
- Krijimi, furnizimi dhe funksionalizimi i 5 laboratorëve;
- Krijimi i bibliotekës dhe datotekës;
- Sigurimi i hapësirave për pushim dhe freskim (kantina e studentëve dhe e mësimdhënësve);
- Krijimi i sallave të leximit dhe hapësirave për punë individuale e grupe;
- Krijimi i hapësirave të digjitalizuara, dhomave për prezantime, dhomave për punë praktike e të tjera.

5.5. Digjitalizimi i mësimdhënies

Akademia tashmë ka filluar me aplikimin e sistemit digjital të mësimdhënies e të studimeve. Gjatë periudhës së këtij plani do të bëhet avancimi dhe funksionalizimi i plotë i SEMS-it.

- Hartimi, menaxhimi, ruajta dhe aplikimi i sistemit të digjitalizuar dhe i bazës së të dhënave për studentë e personelin (përfshirë SEMS);
- hartimi i udhëzuesve për përdorim të sistemit digjital SEMS;
- Aplikimi i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë aplikimit të sistemeve të ndryshme të digjitalizuara të mësimdhënies e të studimeve;
- Krijimi i mundësive për testimin online të studentëve.

5.6. Digjitalizimi i administratës

Digjitalizimi i shërbimeve administrative (shih edhe më poshtë 5.7.). Kjo do të përfshijë edhe sistemin e

digjitalizuar të menaxhimit të dhënave administrative të personelit, përfshirë edhe e Portfolion e personelit të Akademisë.

- Hartimi i udhëzuesve për përdorim të sistemit digjital;
- Trajnimi i personelit mbi përdorimin e teknologjisë digjitale;

5.7. Digjitalizimi i shërbimeve studentore

Krahas shërbimeve të vazhdueshme për studentët, përmes zyrave përkatëse, Akademia do të siguroj të të gjitha shërbimet elektronike përmes platformave të ndryshme digjitale. Shërbimet tona elektronike ofrojnë mbështetje dhe udhëzim të studentëve që nga pranimi, përkrahja financiare, regjistrimi, gjatë studimeve dhe pas diplomimit. Të gjitha këto shërbime kanë për qëllim që të sigurojnë përkrahje efektive dhe konsistente për studentët dhe të realizojnë politikat e programet e Akademisë për shërbime inovative arsimore dhe kurrikulare në përputhje me misionin dhe politikat e Akademisë në programe. Akademia tashmë ka në dispozicion një sërë shërbimesh të digjitalizuara, mirëpo në ndërkohë është krijuar komisioni dhe janë ndarë fondet për të avancuar më tej këto sisteme.

Shërbimet elektronike për studentët, të cilat janë në dispozicion dhe do të avancohen më tutje janë si

në vijim:

- **Webmail:** ”Përmes këtij sistemi, arrihet komunikimi me të gjithë studentët, qoftë në mënyrë individuale apo edhe komunikim me grupe të caktuara. Të gjithë studentët e AKADEMISË, por edhe stafi akademik, posedojnë llogarinë e tyre në domenin tonë, gjë që mundëson komunikimin e vazhdueshëm mes vete;
- **E-Services:** Është platformë digjitale, e cila ndihmon që studenti të jetë i shërbyer 24 orë, edhe pa prezencën e tij në hapësirë atë Akademisë. Përmes këtij shërbimi, studentët do të kenë qasje të vazhdueshme në informacionet që kanë të bëjnë me zhvillimet në Tempull. Studentit i mundësohet që përmes kësaj platforme, të regjistrojë semestrat; të përcaktojë lëndët që dëshiron të ndjekë; të shkarkojë materialet që shpërndajnë mësimdhënësit; të paraqesin provimet; të marrin rezultatet e tyre; dhe shumë mundësi të tjera;
- Gjatë periudhës së kësaj strategjie, Akademia do të mundësojë edhe shtypjen online dhe të përshtatur (customized) sipas nevojave të studentëve të certifikatave të ndryshme studentore (eKiosK);
- **SMS:** Përmes mesazheve telefonike SMS, të gjithë studentët e Akademisë njoftohen në kohë reale me lajmet dhe informacionet që janë të rëndësishme për ta.

Treguesit Kryesorë të Performancës

- Numri i botimeve në bibliotekën e Akademisë;
- Qasja në burimet elektronike akademike;
- Numri i kompjuterëve të cilët mund të përdorë nga studentët gjatë tërë kohës;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve me bibliotekën kombëtare dhe ato komunale;
- Numri i hapësirave për lexim dhe atyre sociale të studentëve brenda Akademisë;
- Krijimi i hapësirave të reja;
- Dixhitalizimi i shërbimeve studentore.

- Më shumë se 75% të studentëve të kënaqur me shërbimet studentore në Akademia;
- Rritja e vëllimeve dhe literaturave të reja në bibliotekë çdo vit;
- Vendosija e së paku 30 kompjuterëve në salla të mësimit të pajisura me softwere adekuate si dhe se paku 5 kompjuterëve në hapësira të veçanta në Akademia për përdorim nga studentët në vitin 2021;
- Krijimi i së paku një hapësire për lexim për student në vitin 2021;
- Krijimi i hapësirës sociale (kafeterisë) për student në vitin 2021;
- Nënshkrimi i marrëveshjes me bibliotekën kombëtare në vitin 2021;
- Ndërtimi i kampusit të ri të Akademisë në vitin 2023;
- Përfundimi i sistemit të menaxhimit të studentëve në vitin 2021;

6. Studentët
6.1. Përkrahja e mobiliteteve
Ngritja e kapaciteteve dhe përkrahja e studentëve për mobilitete (gjuhët, vizat, plotësimi i aplikacioneve, pranimi i kreditave, lirimi nga disa pagesa, përkrahja administrative e logjistike, etj.)
6.2. Bashkëpunimi me shkollat për informimin dhe rekrutimin e studentëve të rinj
Akademia do të organizojë aktivitete tradicionale në shkallë vendi, me nxënës përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të Republikës së Kosovës që do t'i zhvillojnë në kuadër të fushatave vetëdijësuese për sigurinë në rrugë, do t'i njoftojë mbi mundësit dhe nevojën e mësimin në programe profesionale dhe shkencore të specializuara që i ofron Akademia. Pas kësaj, menaxhmenti i Akademisë do të punojë me MASH për organizimin e moduleve të trafikut dhe sigurisë në trafik si kurse zgjedhore në kuadër të kurrikulës së rregullt në shkolla.
Aktivitet
<ul style="list-style-type: none"> – Vizitë e maturanëve në ambientin dhe laboratorët e Akademisë; – Informim (këshillim karriere për maturanët); – Kurse për test të maturës; – Aktivitete garuese; – Kurse përgatitore në fushat që lidhen me fushat e programet e Akademisë; – Hartimi dhe zbatimi i moduleve të sigurisë në trafik nëpër shkollat partnere (në bashkëpunim me komunat dhe autoritetet qendrore arsimore).
6.3. Studentët e diplomuar
Akademia përmes zyrës së Karrierës do t'i inkurajojë studentët në planifikimin e karrierës duke i përgatitur për treg të punës dhe duke i mbështetur në mënyrë të vazhdueshme interesat, vlerat, aftësitë dhe personalitetin e tyre me botën e punës. Akademia nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, takimeve të studenteve do të zhvillojë shërbimet për studentët e diplomuar (Alumni) duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ata për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit (për ata që janë të punësuar) dhe për të ofruar mundësi punësimi dhe këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende.
Aktivitetet:
<ul style="list-style-type: none"> – Informim dhe Orientim Profesional; – Këshillim Profesional; – Punësim; – Vullnetarizëm dhe mbështetje; – Përkrahja e studentëve të diplomuar; – Organizimi i Zyrës dhe shërbimeve për Alumni; – Mbledhja e informatave për të diplomuarit; – Mbledhja e informatave për punësim.
6.4. Sigurimi i mbështetjes së shtuar për procedurat transparente dhe pjesëmarrëse të sigurimit të cilësisë për studentët

Vlerësimet e studentëve përfshihen në vlerësimin e performancës

Akademia do të organizojë vlerësimin e personelit dhe të gjitha shërbimeve akademike dhe administrative nga studentët. Për këtë qëllim do të përdoren pyetësorë të ndryshëm, si dhe diskutime mbi grupet e fokusit dhe kutinë e ankesave. Rezultatet e inputeve të tilla do të përfshihen në dokumentet dhe procedurat e vlerësimit të performancës së personelit akademik dhe administrativ.

Përmirësimi i mbështetjes për studentët nga mësuesit

Performanca e studentëve është parakushti për të përcaktuar nëse ata janë të përgatitur për sfidat në tregun e punës. Mësuesit janë në dispozicion të studentëve për të rritur performancën e tyre.

Aktivitetet e ndryshme zbatohen duke përdorur pajisje dhe mjete të ndryshme:

- klasa shtesë për arritjen e objektivave të të nxënit,
- duke përdorur pajisje laboratorike,
- përdorimi i IT për qëllim të të mësuarit,
- furnizim me literaturë,
- njohja me projekte të fushave të ndryshme.

Komunikimi me studentët

Hartimi dhe miratimi i rregullores për komunikimin e brendshëm - përbërësi për studentët Në strategjinë e saj, Akademia është përqendruar tek studenti, prandaj do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar shërbimet për studentët duke filluar nga komunikimi i ndërsjellë. Do të zhvillohet një plan i hollësishëm veprimi, i cili do të vendosë mbi objektivat dhe udhëzimet për përmirësimin e komunikimit. Akademia do të krijojë mekanizmin e "ombudspersonit" të studentëve në Akademi për të lehtësuar komunikimin midis personelit, menaxhmentit dhe studentëve në Akademi. "Ombudspersoni" do të sigurohet pavarësia dhe mbështetja e plotë për funksionimin e mekanizmit.

Aktivitetet

- Emërohet student i "ombudsperson" në Akademi
- Rregullorja për Avokatin e Popullit është hartuar dhe zbatuar
- Rregullorja për komunikimin e brendshëm Operacionalizimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të studentëve.

6.5. Caktimi i zyrës së Këshillimit të Karrierës

Organizimi i aktiviteteve që informojnë studentët e Akademisë, por edhe studentët e ardhshëm për programet e studimit, por edhe për procedurat në frymën e Akademisë.

Organizimi i aktiviteteve që informojnë studentët e Akademisë, por edhe studentët e ardhshëm për programet e studimit, por edhe për procedurat në frymën e Akademisë. Zyra për Këshillimin e Karrierës do të menaxhojë dhe mbështesë vazhdimisht Këshillin e Studentëve, i cili është një zinxhir i rëndësishëm në jetën studentore. Në bashkëpunim me Zyrën e Alumni, ai do të këshillojë studentët për shqetësimet personale që kanë të bëjnë me vendimet për karrierën, duke i drejtuar ata në kërkimin e punës. Ai do të sigurojë mbështetje dhe shpjegime për pyetjet e bëra nga studentët në lidhje me punësimin, mundësitë e punësimit ose iniciativa të tjera.

Aktivitetet

- Informacion dhe udhëzime profesionale
- Bazat e të dhënave të statistikave të punësimit
- Organizimi i tryezave të rrumbullakëta për çështjet e orientimit në karrierë dhe punësimit
- Trajnim për ndërtimin e aftësive themelore
- Pyetëtori vjetor për anëtarët e asociuar
- Vlerësimi i ndërsjellë

6.6. Puna praktike

Zbatimi i rregullores dhe aktiviteteve të punës praktike (për shembull: caktimi i personave përgjegjës, hartimi i formularëve, mbledhja e informatave.

Qëllimi kryesor i Akademisë është që studentet e vet t'i aftësojë në atë mënyrë, që të jenë të gatshëm për tregun e punës. Gërshetimin e pjesës praktike të studimeve me atë teorike Akademia e ka realizuar duke krijuar marrëveshje dhe kontrata bashkëpunimi me institucione e kompani të profileve përkatëse për të mundësuar punën praktike të studentëve në të gjitha programet studimore. Synimi i Akademisë është që të lidh:

Aktivitetet

et:

- Rishikimi i rregullores për punë praktike;
- Rishikimi i udhëzuesit të praktikës;
- Mbikëqyrja;
- Vlerësimi i ditarit praktik.

6.7. Aktivitetet jashtë mësimorë për socializimin e studentëve

Menaxhimi i Akademisë do të organizojë aktivitete të shumta që synojnë socializimin e studentëve, rritjen e performancës në studime dhe përafrimin e studentëve me institucionin. Për këtë qëllim, do të organizohen aktivitete të ndryshme të tilla si ceremonitë e diplomimit, komuniteti, mjedisi, sporti, aktivitetet kulturore dhe të tjera. Një fond i veçantë do të caktohet për këto aktivitete, i cili do të menaxhohet në mënyrë transparente nga organizata studentore e Akademisë.

Treguesit Kryesorë të Performancës

- Kënaqshmëria e studentëve me shërbimet akademike dhe administrative të cilat ofrohen në Akademia;
- Numri i studentëve të regjistruar në Akademi;
- Përqindja e të diplomuarve (studime universitare dhe pasuniversitare) në nivelin e diplomës ose studime të mëtejshme;
- Numri i organeve vendimmarrëse të Akademisë ku studentët janë të përfaqësuar.

Caqet

- 75% të studentëve të kënaqur me shërbimet dhe aktivitetet studentore;
- Rritja e interesimit të nxënësve për të studime në Akademia nga viti në vit ;
- Rritja e interesimit të studentëve për të studime jashtë vendit nga viti në vit ;
- Pjesëmarrja e studentëve në të gjitha organet vendimmarrëse.

Analiza e buxhetit

Plani i zbatimit dhe buxheti, përfshijnë gjithë periudhën e zbatimit të Planit Strategjik të Akademisë për vitet 2021-2025. Kostoja totale e zbatimit të Planit Strategjik për periudhën 2021-2025 është vlerësuar të jetë 824,100.00 euro. Si plani i zbatimit, ashtu edhe planifikimi i buxhetit brenda periudhës së planifikuar, janë orientues dhe në parim kërkojnë të rishikohen në baza vjetore. Në bazë të këtij planifikimi, Akademia pritet të sigurojë rreth 150,000,00 euro në vit për zbatimin me sukses të masave të parapara – pa llogaritur koston e ndërtimit të kampusit të ri dhe pagat e numrit ekzistues të personelit. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të buxhetit për realizimin e planit janë paraparë të janë nga burimet vetanake të Akademisë të gjeneruara nga pagesat e studentëve dhe të kursistëve për vozitje dhe për instruktorë dhe në trajnimet tjera për transportues. Një pjesë e të hyrave pritet të realizohet edhe nga ekspertizat dhe nga projektet e ndryshme për autoritete e fonde vendore e ndërkombëtare. Të hyrat e tilla pritet të shtohen pas vitit 2022 kur edhe besohet se do të ndërtohen kapacitetet e personelit për ekspertiza, projekte zhvillimore dhe për hulumtime (bazike e të aplikuara). Një pjesë pritet të realizohet nga aktivitete komerciale.

Para fillimit të çdo viti, Akademia do të analizojë me kujdes mjetet në dispozicion nga të hyrat, me qëllim që të sigurohet financim i qëndrueshëm i veprimtarisë së Akademisë.

Tabela në vijim, prezanton përmbledhjen e buxhetit të nevojshëm për realizimin e planit, sipas fushave të intervenimit.

N r	Fusha	2021	2022	2023	2024	2025	Gjiths ej
1	Menaxhimi administrata e	32,000	37,000	37,000	39,000	39,000	184,000
2	Mësimdhënia e SC	20,000	23,000	25,000	26,000	26,000	120,000
3	Hulumtimi shkencor	18,000	18,000	18,000	20,000	20,000	94,000
4	Bashkëpunimi dhe PR	25,000	25,000	26,000	28,000	29,000	133,000
5	Infrastruktura e dixhitalizimit.	12,000	15,500	18,000	19,000	23,000	87,500

6	Studentët	11,000	12,000	15,000	18,000	25,000	81,000
	Gjithsej për vite	118,000	130,500	139,000	150,000	162,000	699,500

Masat e parapara në këtë plan janë kryesisht të karakterit zhvillimor dhe (pos ndonjë rasti kur parashihet vend i ri i punës) nuk përfshijnë shpenzimet operative (pagat, mirëmbajtjen e rregullt të objekteve, karburantet, shpenzimet komunale, shpenzimet për ngrohje dhe të tjera). Shpenzimet kryesore të planit janë investimet në infrastrukturë, në zhvillimin e administratës dhe në menaxhimin e Akademisë, në bashkëpunim, e të tjera.

Plani parasheh që gjatë pesë viteve të ardhshme Akademia duhet të sigurojë rreth 699.500.00 euro në total, ose rreth 145.000.00 euro mesatarisht për secilin vit të zbatimit të Strategjisë. Një shumë e tillë do të jetë e mundshme vetëm me një zhvillim më të hovshëm të Akademia duke shtuar numrin e studentëve (përfshirë të atyre nga rajoni dhe nga vende të treta), duke shtuar shërbimet për industrinë, duke konkurruar për fonde ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë e të shkencës e të tjera. Një kosto e tillë e planit strategjik kërkon edhe një investim të shtuar në marketing, në marrëdhënie me publikun dhe në shërbime komunitare.

Investimet në infrastrukturë paraqesin pjesën më të madhe të shpenzimeve të Planit Strategjik në periudhën e ardhshme pesëvjeçare. Akademia tashmë ka siguruar një burim të investimeve për kampusin e ri nëpërmjet të përdorimit të vlerës së patundshmërive në hapësirën e kampusit të ri. Një zgjidhje e tillë nuk do të rrezikojë funksionimin e Akademisë as aktivitetet akademike e profesionale.

Pjesa tjetër e shpenzimeve mund të mbulohen lehtësisht nga të hyrat nga studentët/kursistët dhe nga mjetet e gjeneruara nga aktivitetet komerciale. Pjesa e mbetur parashihet për zhvillimin e rregulloreve e procedurave të ndryshme, për zhvillimin e personelit të Akademisë dhe për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare (projektet dhe hulumtimet shkencore). Struktura e shpenzimeve të parapara të këtij plani reflekton edhe prioritetet zhvillimore të Akademisë në periudhën e planifikuar, që janë menaxhimi më i mirë, hartimin e projekteve për aplikim për fonde të donatorëve, e të tjera.

Në shtojcën e buxhetit të këtij plani, janë prezantuar detajet e planit të veprimit dhe të buxhetit, përfshirë aktivitetet sipas masave, treguesit për aktivitetet sipas masave, periudha e zbatimit, përgjegjësitë, përshkrimi i buxhetit dhe ndarja e buxhetit në vite

Analiza e rrezikut

Gjatë hartimit të Planit zhvillimor strategjik të Akademisë, grupet punuese janë angazhuar edhe për vlerësimin e rreziqeve të ndryshme, faktorë kryesisht jashtë kontrollit të Akademisë – që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e suksesshëm të Planit. Identifikimi i rreziqeve u bë si gjatë analizës SWOT ashtu edhe gjatë hartimit të masave dhe aktiviteteve për realizimin e objektivave të planit. Rreziqet janë analizuar pa një renditje të caktuar, duke analizuar shkallën e probabilitetit dhe shkallën e mundshme të ndikimit në zbatimin e masave të planit.

Siç do të shihet në tabelën në vijim, shumica e rreziqeve të zbatimit të këtij Plani lidhen me kornizën ligjore, paqëndrueshmërinë e autoriteteve shtetërore, me gjendjen ekonomike e përfituesve të shërbimeve të Akademisë, mungesën e ekspertizës në fushën e shkencave teknike e të tjera. Në fund, shkurtimisht janë menduar edhe strategjitë e ndryshme për parandalimin, zvogëlimin e efektit negativ ose për tejkalimin e rrezikut.

Ajo që lë përshtypje më të madhe gjatë hartimit të kësaj kornize të rreziqeve ishte vlerësimi i probabilitetit dhe i shkallës së ndikimit të tyre. Këto dy dimensionet ishin vazhdimisht të shkallës mesatare ose të lartë, gjë që e bënë sektorin e arsimit privat një veprimtari shumë të pasigurte në Kosovë, në veçanti për institucionet e vogla private.

Tabela më poshtë paraqet rreziqet dhe masat për parandalim ose luftim të tyre:

Rreziqet:	Probabiliteti	Shkalla e ndikimit	Masat për parandalim
Korniza e paparashikueshme ligjore e MASH	I lartë	Mesatar	Komunikim me autoritetet
Ndërrimet e shpeshta të kritereve e standardeve	I lartë	I lartë	Fillimi i një dialogu për avancimin e komunikimit në mes të KAA dhe IAL-ve
Mungesa e ekspertizës në profilet e Akademisë (lëmit teknike)	Mesatar	Mesatar	Ndërtimi i kapaciteteve dhe ekspertizës në profilet deficitare
Niveli jo i kënaqshëm i studentëve të pranuar nga shkolla e mesme	I lartë	I lartë	Bashkëpunimi me shkollat për informim dhe Aplikimi i qasjes së individualizuar
Emigrimi i popullatës, me fokus në gjeneratat e reja	Mesatar	Mesatar	Zhvillim i programeve online dhe internacionalizimi i studimeve
Qasje jo konstruktive e autoriteteve	Mesatar	Mesatar	Intensifikim i marrëdhënieve

arsimore ndaj disa IAL private			me publikun
Diskontinuitetet në funksionimin e AKA	I lartë	I lartë	Mendohet për një akreditim ndërkombëtar Intensifikimi I komunikimit
Konkurrenca jo lojale në ndarjen e granteve dhe subvencioneve për hulumtime dhe projekte	Mesatar	Mesatar	Ngritja e kapaciteteve për hartim të projekteve dhe angazhimi i përfaqësuesve ligjorë për mbrojtjen e interesave të Akademisë
Mos akreditimi i Akademisë	I lartë	I lartë	Hartimi dhe zbatimi i planit për konsolidim institucional dhe akreditim;
Kushtet ekonomike	Mesatar	Mesatar	Sigurimi i fondeve dhe burimeve të tjera të financimit
Paragjykimet ndaj arsimit privat në Kosovë	Mesatar	Mesatar	Organizimi më i mirë i PR dhe komunikimit me mediat
Keqpërdorimet në punësime në institucionet publike	Mesatar	Mesatar	Angazhim i përfaqësimit ligjor në disa raste Përkrahja e studentëve të diplomuar Organizimi i Zyrës dhe shërbimeve për Alumni-n

Strategjia e komunikimit të planit

Akademia ka zhvilluar një proces me pjesëmarrje relativisht përfshirëse për hartimin e Planit Zhvillimor 2021-2025. Plani është miratuar fillimisht nga Koordinator i Programit e pastaj nga Këshilli Drejtues i Akademisë. Pas miratimit të Planit, Akademia do ta publikojë pjesët përkatëse të Planit në ueb faqen e vet, në faqen në fejsbuk (Facebook), si dhe në platforma përkatëse për informim dhe pranim të informatave kthyes nga partnerët nga ekonomia, komuniteti, nga organizatat joqeveritare dhe nga komuniteti akademik në Kosovë e më gjerë.

Aktivitetet e strategjisë së komunikimit për këtë plan do të bashkërenditen nga Drejtori i Akademiës dhe nga zyra për marketing. Kohë pas kohe, Akademia do të bashkëpunojë me partnerët e ndryshëm vendorë e ndërkombëtarë - sidomos në kohën e shqyrtimit të zbatimit dhe rishikimit të planit. Akademia të organizojë mbledhjen e rregullt të informatave dhe raportimin vjetor lidhur me cilësinë e zbatimit të Planit, si dhe do të informojë palët e interesit lidhur me këtë.

Pas miratimit nga Këshilli Drejtues, Akademia do të hartojë materialet për informim të palëve të interesit në fushën e arsimit, përfshirë bizneset, autoritetet, donatorët, OJQ-të. Për këtë qëllim do të hartohen fletëpalosje dhe broshura përkatëse informuese, ndërsa në ueb faqe do të jetë vazhdimisht i publikuar plani. Materialet në ueb faqe do të publikohen në gjuhën shqipe, angleze dhe në gjuhët lokale në mënyrë që të mbërrijë sa më shumë përfitues dhe palë të interesuara.

Pos kësaj do të organizohen edhe takime informimi me partnerë, biznese e me donatorë për të mobilizuar entitetet e caktuara për zbatimin e masave të planifikuara në plan, e sidomos për përkrahjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me punën praktike, bashkëpunimin në projekte të përbashkëta, zhvillimin e cilësisë dhe bashkëpunimin me industrinë. Pastaj, do të organizohet një ngjarje informative me bizneset, autoritetet, donatorët dhe mediat me qëllim të informimit të ndërsjellë dhe për vlerësimin e mundësive për bashkëpunim në zbatimin e aspekteve të Planit varësisht nga interesimi dhe mundësitë e palëve të përfshira. Në veçanti, një aktivitet i rëndësishëm i komunikimit do të jetë përcjellja e punimeve për ndërtimin dhe hapjen e kampusit të ri të Akademisë.

Secilin vit, në muajit korrik do të bëhet shqyrtimi i zbatimit të masave të planit dhe hartimi i planit vjetor të veprimit për vitin përkatës. Në këtë punëtori të rishikimit e të planifikimit do të përfshihen edhe partnerët e Akademisë nga sektori i biznesit, si dhe ata në sektorin e arsimit të lartë dhe mediat. Këto punëtori shqyrtuese do të shërbejnë edhe për të rishikuar e shtuar mobilizimin e partnerëve për zbatimin sa më të mirë të tij. Në veçanti, gjatë procesit të shqyrtimit të zbatimit, do t'i kushtohet rëndësi masave që kanë të bëjnë me zhvillimin e cilësisë, ndërtimin e kampusit të ri, ndërtimin e kapaciteteve të personelit e të studentëve e të tjera.

Në vitin 2022 do të bëhet rishikimi i ndërmjetëm i zbatimit të planit. Me këtë rast do të organizohet një punëtori me përfshirje më të gjerë, duke përfshirë partnerët nga ekonomia, komunitetin akademik, OJQ- të, autoritetet arsimore qendrore dhe partnerët rajonalë. Ky proces do të

nënkuptojë një shqyrtim të zbatimit dhe rishikim të masave të parapara në planin origjinal. Kjo do të bëhet për t'i përshtatur masat me kontekstin e ndryshuar të sektorit të arsimit – me fokus në fushën e shkencave të aplikuara - në Kosovë e më gjerë. Kjo ngjarje do të shërbejë edhe për mobilizimin e mjeteve shtesë për financimin e planit, por edhe për kapitalizmin nga mundësi të tjera për zbatim të Planit që mund të dalin si rezultat i avancimit të procesit të integritimeve evropiane, rritjes së fuqisë ekonomike dhe të interesimit të partnerëve nga ekonomia, të donatorëve, ose rritjes së interesimit të autoriteteve për bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë.

Pos këtyre formave të komunikimit e informimit, do të shfrytëzohen edhe mjetet e informimit (elektronike dhe të shtypura) me qëllim të informimit sa më të mirë të opinionit për procesin zbatimit, përfshirë sfidat dhe sukseset, e këtij plani.

Shtojca 1. Plani i monitorimit

	TKP	Caqet	Periudha e implementimit	Statu si 2021	Statu si 2022	Statu si 2023	Statu si 2024	Statu si 2025
Menaxhimi dhe administrata	Draftimi i rregulloreve,	Draftimi i rregulloreve kryesore deri me 31 dhjetor 2021,	2021					
		Draftimi i rregulloreve tjera deri me 31 mars 2021,	2021					
	Aprovimi i rregulloreve,	Aprovimi i rregulloreve me 3 janar 2021,	2021					
	Numri i mobiliteteve akademike dhe aktivitetet tjera shkencore të realizuara të stafit,	Pjesëmarrja e së paku 3 mësimdhënësve në mobilitete akademike deri në vitin 2024	2023					
	Numri i punëtorive për zhvillimin e stafit	Organizimi i së paku një aktiviteti për zhvillimin e stafit akademik në vit	Vjetore					
	Krijimi i bazës së të dhënave për tregun e punës.	Krijimi i bazës së të dhënave për tregun e punës.	2021					
Mësimdhënia dhe sigurimi i cilësisë	Akreditimi i programeve te reja te studimit,	Akreditimi i së paku dy programeve te reja te studimit në vitin 2021	2021					
		Akreditimi i së paku pesë programeve te reja te studimit deri në vitin 2025	2025					

	Gatishmëria e akterëve të brendshëm dhe jashtëm në pjesëmarrje në proceset e sigurimit të cilësisë në Tempull,	Pjesëmarrja e së paku 5 bizneseve në hartimin dhe rishikimin e programeve të studimit,	Vjetore					
	Involvimi i bizneseve në hartimin e programeve të studimit.							
	Realizimi i aktiviteteve të karrierës për studentët, drejt zhvillimit të tyre profesional,	Realizimi i së paku katër aktiviteteve për zhvillimin e karrierës së studentëve cdo vit,	Vjetore					
	Realizimi i punës praktike të studentëve,	Cdo student i vitit të tretë të studimeve realizon punën praktike	Vjetore					
	Nivel i lartë i performancës së stafit akademik,	80% e stafit tregojnë performancë të pranueshme në Akademia cdo vit	Vjetore					
Hulumtime t shkencore	Numri i projekteve të përbashkëta vendore dhe ndërkombëtare hulumtuese,	Së paku një bashklëpunim në vit me partner vendor dhe ndërkombëtar në projekte të përbashkëta shkencore,	Vjetore					
	Numri i ekspertizave shkencore të realizuara nga stafi i Akademisë,							
	Pjesëmarrja në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, ku do të shfaqen njohuritë e fituara praktike, përmes hulumtimeve të ndryshme.	Pjesëmarrje në 5 konferenca ndërkombëtare në vit nga stafi akademik	Vjetore					
	Numri i punimeve kërkimore të stafit akademik dhe studentëve të Akademisë të publikuara në revista ndërkombëtare si bashkë-autorë,	Mesatarisht një punim shkencor të publikuar nga secili staf akademik në vit, Themelimi i fondit për kërkim në Akademia për përkrahje të	Vjetore 2021					

		punës hulumtues të stafit dhe studentëve,							
	Organizimi i suksesshëm i konferencave ndërkombëtare,	Organizimi i së paku një konference në vit në bashkëpunim me institucionet, universitetet ndërkombëtare,	Vjetore						
	Thellimi i bashkëpunimit ndërmjet mësimitdhënësve në punët e tyre kërkimore shkencore.	Së paku pesë hulumtime dhe publikime të përbashkëta në mes të mësimitdhënësve të Akademisë.	2025						
Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publiku	Identifikimi i stafit dhe studentëve me Misionin, Vizionin dhe Vlerat e Akademisë,	90% e stafit dhe 80% e studentëve identifikohen me Misionin dhe Vlerat e Akademisë,	Vjetore						
	Anëtarësimi së paku në një nga asociacionet ndërkombëtare të universiteteve,	Anëtarësimi në njërin nga asociacionet e universiteteve në vitin e parë të implementimit,	2021						
	Nënshkrimi i marrëveshjeve me institucione ndërkombëtare,	Nënshkrimi i së paku një marrëveshje ndërkombëtare në vit,	Vjetore						
	Aplikimi në projekte ndërkombëtare,	Hartimi i së paku dy projekt propozimeve në projekte ndërkombëtare deri në fund të vitit 2025,	2025						
	Partner në projekte ndërkombëtare të llojit Erasmus+, etj.,	Aplikim si partner në së paku një projekt Erasmus+ në secilin vit,	Vjetore						

	Shkëmbimi i studenteve, stafit me universitetet ndërkombëtare,	Pjesëmarrja e së paku 3 mësimdhënësve dhe studentëve në mobilitete ndërkombëtare (në shkuarje dhe ardhje) deri në fund të vitit 2024,	2025						
	Numri i ligjëruesve mysafir (guest lecturer) në Akademia,	Pjesëmarrja së paku një mësimdhënësi ndërkombëtar në vit në ligjërata me student dhe staf akademik të Akademisë	Vjetore						
	Realizimi i aktiviteteve në komunitet,	Së paku dy aktivitete të realizuara në komunitet	Vjetore						
	Aktivitete me shkolla në Kosovë.	Organizimi i së paku një aktiviteti me shkolla të Kosovës në vit.	Vjetore						
Infrastruktura e digjitalizimi	Numri i botimeve në bibliotekën e Akademisë,	Rritja e vëllimeve dhe literaturave të reja në bibliotekë cdo vit,	Vjetore						
	Qasja në burimet elektronike akademike,	Më shumë se 75% të studentëve të kënaqur me shërbimet studentore në Akademia,	Vjetore						
	Numri i kompjuterëve të cilët mund të përdorë nga studentët gjatë tërë kohës,	Vendosja e së paku 30 kompjuterëve në salla të mësimit të pajisura me software adekuate si dhe së paku 5 kompjuterëve në hapësira të veçanta në Akademia për përdorim nga studentët në vitin 2021,	2021						

	Nënshkrimi i marrëveshjeve me bibliotekën kombëtare dhe ato komunale,	Nënshkrimi i marrëveshjes me bibliotekën kombëtare në vitin 2021,	2021						
	Numri i hapësirave për lexim dhe atyre sociale të studentëve brenda Akademisë,	Krijimi i hapësirës sociale (kafeterisë) për student në vitin 2021,	2021						
	Krijimi i hapësirave të reja,	Ndërtimi i kampusit të ri të Akademisë në vitin 2023,	2023						
	Dixhitalizimi i shërbimeve studentore.	zhvillimi i sistemit të menaxhimit të studentëve në vitin 2021.	2021						
Studentët	Kënaqshmëria e studentëve me shërbimet akademike dhe administrative të cilat ofrohen në Akademia,	75% të studentëve të kënaqur me shërbimet dhe aktivitetet studentore,	Vjetore						
	Numri i studentëve të regjistruar në Akademia,	Rritja e interesimit të nxënësve për të studime në Akademia nga viti në vit,	Vjetore						
	Përqindja e të diplomuarve (studime universitare dhe pasuniversitare) në nivelin e diplomës ose studime të mëtejshme,	Rritja e interesimit të studentëve për të studime jashtë vendit nga viti në vit,	Vjetore						
	Numri i organeve vendimmarrëse të Akademisë ku studentët janë të përfaqësuar.	Pjesëmarrja e studentëve në të gjitha organet vendimmarëse.	Vjetore						

